

EPPC Albania po kërkon një **Interior Architect** për klientin e saj, një *studio arkitekture*.

Përgjegjësitë Kryesore:

- Zhvillimi i koncepteve arkitekture të brendshme nga faza fillestare deri në dokumentacionin e ndërtimit, përfshirë planifikimin e hapësirës dhe përzgjedhjen e materialeve;
- Bashkëpunim i ngushtë me klientët për të kuptuar vizionin e tyre, prezantimi i propozimeve të dizajnit dhe përfshirja e komenteve gjatë gjithë procesit të projektit;
- Hartimi i vizatimeve teknike të detajuara, planeve, elevacioneve dhe vizualizimeve 3D duke përdorur programe si AutoCAD, Revit dhe SketchUp;
- Koordinimi me arkitektë, inxhinierë, kontraktorë dhe furnitorë për të siguruar që vizioni i dizajnit të ruhet gjatë realizimit të projektit;
- Sigurimi që të gjitha dizajnet përputhen me kodet lokale të ndërtimit, kërkesat e aksesueshmërisë, standardet e qëndrueshmërisë dhe rregulloret e sigurisë dhe shëndetit.

Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Diplomë Universitare në Arkitekturë ose Interior Dizajn;
- **Minimumi 3 vite përvojë profesionale** në arkitekturë apo dizajn të brendshëm, preferohet në projekte komerciale, turizmi ose rezidenca premium;
- **Njohuri të programeve dizajni si AutoCAD, Revit, Adobe Creative Suite, SketchUp dhe programe vizualizimi (p.sh. Lumion, V-Ray);**
- Aftësi të mira komunikimi dhe prezantimi, me vëmendje ndaj detajeve;
- Të ketë leje drejtimi automjeti.

Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni aplikimin tuaj duke ndjekur linkun:

<https://aplikim.eppc.al>

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj do të kualifikohet.

Tek ne CV-ja juaj është e sigurt dhe trajtohet në konfidencialitet të plotë.